
**SË BASHKU për NDERIN dhe DINJITETIN e
UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

**Prof. Mimoza HAFIZI
Korrik 2020**

Jam fizikane, e diplomuar në Universitetin e Tiranës, në vitin 1985, me Medalje të Artë. Në vitin 1995 jam doktoruar në Universitetin Paris 7, në fushën e Fizikës Teorike. Që prej 25 vitesh jam pjesë e Departamentit e Fizikës. Në periudhën 2008-2012 kam qenë drejtuese e këtij Departamenti.

Gjatë gjithë karrierës sime shkencore, krahas mësimdhënies në universitet i jam përkushtuar kërkimit shkencor. Përpos pjesëmarrjes në disa dhjetra konferenca shkencore ndërkombëtare, jam autore e mbi 40 artikujve shkencorë, shumica prej të cilëve të botuar në revista ndërkombëtare. Jam autore e disa teksteve universitare.

Jam Profesore që nga viti 2012 dhe së fundmi jam zgjedhur Anëtare e Asociuar e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë.

Jam Anëtare e Bashkimit Ndërkombëtar të Astrofizikanëve.

Prej më shumë se dy dekadash jam bashkëpunëtore me qendra shkencore dhe universitete në Francë dhe Itali.

Prej shumë vitesh, e motivuar nga interesi për popullarizimin e shkencës, kam organizuar me dhjetra aktivitete vrojtimi astronomik, me publikun e gjerë dhe me nxënësit e shkollave. Në këtë linjë kam botuar edhe një roman me profil shkencor, për të cilin jam vlerësuar me një Çmim Kombëtar Letrar.

Universiteti i Tiranës është i pandarë nga jeta ime qëkur kam nisur studimet për Fizikë, në vitin 1980.

Kjo qendër e madhe arsimore, një pasuri kombëtare e padiskutueshme, ka mbledhur në vite vlerat më të mira të intelektualëve dhe profesorëve tanë të nderuar. Ajo ka ushqyer dijet, zellin dhe pasionin e brezave të tërë specialistësh, në të gjitha fushat.

Dhjetra mijëra studentë besojnë tek Universiteti i Tiranës.

Por sot, Universiteti ynë përjeton një rën të rëndësishme nga periudhat më të vështira të historisë së vet. Autoritetet dhe organet e tij drejtuese ndodhen në gjendje paralize funksionale, për arsye mosmarrëveshjesh e sherrnajash pa asnjë lidhje me misionin e Universitetit, por veçse me interesa abuzive. Kjo sjellje e palejueshme e organeve të zgjedhura ka tronditur trupën akademike dhe e ka ftohur me institucionin e vet. Megjithë kualifikimin e lartë, masa e pedagogëve ndihet e stepur për t'ia kushtuar energjitë e veta këtij institucioni të marrë peng nga një grusht njerëzish, që kanë zaptuar prej dy dekadash postet e tij drejtuese. Kjo gjendje ka sjellë pashmangshëm rënien e cilësisë dhe cënimin e imazhit të Universitetit tonë në sytë e shoqërisë, e cila me të drejtë kërkon aty elitën intelektuale të vendit.

Ne mund dhe duhet t'ia kthejmë besimin shqiptarëve në këtë institucion akademik dhe në të gjithë sistemin e arsimit të lartë. Nga Universiteti ynë ne mund t'i japim një sinjal pozitiv të gjithë shoqërisë se demokracia e votës së lirë mund të jenë funksionale edhe në vendin tonë.

Si një nga Ju, duke shprehur shpresën dhe bindjen tuaj se Universiteti ynë i ka të gjitha mundësitë dhe energjitë për të justifikuar besimin dhe kërkesat e shoqërisë në të, kam vendosur të kërkoj votën tuaj për detyrën e REKTORES së UNIVERSITETIT të TIRANËS.

E vetëdijshme në përgjegjësinë e lartë dhe bashkëpunimin e gjithanshëm e të përhershëm që duhet, kam nisur komunikimin intensiv me Ju, kolegë e studentë, për të përfshirë mendimet tuaja të vyera në një program ambicioz të përballimit të sfidave për katërvjeçarin e ardhshëm.

Projekt-PROGRAM

I. Instalimi i mirëkuptimit dhe i bashkëpunimit ndërmjet të gjithë faktorëve nga rradhët e pedagogëve, studentëve, departamenteve dhe fakulteteve, personelit ndihmës e administratës, për një drejtim të përgjegjshëm dhe vizionar të Universitetit

- Senati, rektori, rektorati, dekanët, përgjegjësit e departamenteve, bordi i administrimit, komisionet, administratorët, çdo autoritet e organ i zgjedhur, të ndjehen të frymëzuar nga interesat e përbashkëta të mijëra studentëve dhe qindra pedagogëve e të bashkëpunojnë, duke shmangur presionin e paligjshëm të grupeve të vogla klanore, që rëndom kanë marrë peng vendimarrjen për interesat e tyre abuzive. Askush të mos shohë më tek tjetri rivalin në përfitime, por aleatin në rrugën e përbashkët për realizimin më së miri të misionit të Universitetit.
- Pa vonuar më, të hartohet Rregullorja e Brendshme e Universitetit!
- Universiteti i Tiranës duhet t'i shkëpusë lidhjet me traditën e dëmshme të drejtimit nga të njëjtit njerëz. Le të çelim një epokë të re, ku gjithësecili nga pedagogët e shkëlqyer të të gjitha niveleve ta ndjejë përgjegjësinë e kontributit për drejtimin e tij e ndërkaq të ndjehet i lirë në këtë rrugëtim!
- Të shpërblehet drejt kontributi në administrimin e Universitetit! Jo më pagesa të shpërpjestuara mes pjesëmarrjes në borde e këshilla dhe punës së drejtpërdrejtë në auditor! Shpërblimi i harmonizuar jo vetëm mund të çlirojë një buxhet të konsiderueshëm në dobi të mësimdhënies, por edhe do t'i japë besim punës së organeve drejtuese në sytë e masës së pedagogëve dhe studentëve.
- Të rritet pesha në vendimarrje e njësive bazë, e departamenteve dhe grupeve shkencore. Të forcohet roli në vendimarrje i Profesorit, si qendra e akademizmit dhe kërkimit shkencor.
- Vendimet për financime të rëndësishme të jenë sa më gjithëpërfshirëse. Në rast projektesh madhore, ato mund të marrin formën e referendumit universitar.

- Të ketë transparencë të plotë në marrjen e vendimeve, në të gjitha nivelet.

II. Mbështetje e trupës akademike për cilësi në mësimdhënie e kërkim shkencor

- Të rritet financimi dhe të menaxhohen me kujdes të ardhurat, si faktorë kryesorë për ngritjen cilësore në mësimdhënie e në kërkim shkencor. Problem thelbësor në Universitetin tonë mbetet niveli i ulët i financimit, nga i cili e pësojnë kushtet e punës ende të papërshtatshme si dhe pagat e ulëta të personelit akademik.
- Të rritet pjesëmarrja e Universitetit në projekte kombëtare e ndërkombëtare; të shfrytëzohen mundësitë e krijimit të të ardhurave përmes kërkimit shkencor; të nxitet krijimi i spin-offeve; të ofrohen nga Universiteti shërbime këshillimore, ekspertiza, studime, përkthime, etj. apo programe kualifikuese për grupe të ndryshme, mësues, studentë të sapopranuar në Universitet, etj; të nxitet interesi i donatorëve privatë. Të gjitha këto veprimtari do të shkojnë në dobi të shtimit të të ardhurave të institucionit dhe forcimit të rolit të tij në shoqëri.
- Të krijohet në çdo fakultet një zyrë mbështetje për aplikimin e pedagogëve apo grupeve shkencore në projekte kombëtare dhe sidomos evropiane. Ky burim progresi shkencor dhe buxheti shtesë është shumë pak i shfrytëzuar, edhe për arsye procedurash burokratike, të cilat shkurajojnë personalin akademik dhe ulin besimin e tij në sukses. Bashkë me Universitetet e tjera publike do të këmbëngulet, gjithashtu, për amendime në ligjin e prokurimeve publike dhe në ligjin për menaxhimin financiar, me qëllim heqjen e kufizimeve burokratike, që vijnë në kundërshtim me autonominë financiare të botës akademike dhe pengojnë realizimin e projekteve shkencore me të njëjtën lirshmëri si dhe kolegët tanë në hapësirën evropiane.
- Të bëhet e mundur një shpërndarje vjetore e pagesës së orëve shtesë të punës në auditor, e cila shmang tatimin e padrejtë dhe rrit të ardhurat neto të pedagogut.
- Investimet të kenë në fokus laboratorët shkencore dhe didaktike, si dhe krijimin e mjediseve të përshtatshme të punës e paisjen e personelit akademik me mjetet e nevojshme. Çdo investim të kryhet përmes procedurash transparente.

- Përkundër çfarë ka ndodhur në 30 vitet e fundit, të mbrohet pa kompromis integriteti i Universitetit të Tiranës dhe çdo pronë e tij, e ngritur përmes punës së pakursyer të paraardhësve tanë. Kjo trashëgimi do të konsiderohet e patjetërsueshme! Ajo është bazë për zhvillimin e vlerave të reja në Universitetin e Tiranës.
- Të financohen nga buxheti i Universitetit projekte të propozuara nga grupet shkencore, përmes procedurash konkurruese, mbi bazë kriteresh të përcaktuara në mënyrë transparente e gjithëpërfshirëse. Në këto projekte të përfshihen edhe botimet e monografive apo librave shkencorë si dhe nismat për organizimin e konferencave ndërkombëtare me pjesëmarrjen e personaliteteve të shquara të shkencës dhe akademizmit në fusha të ndryshme.
- Të mbështetet pjesëmarrja e pedagogëve në aktivitete ndërkombëtare, përmes fondesh të përcaktuara në nivel departamenti, sipas disa parimesh të saktësuara bashkërisht: gjithësecili të përfitojë nga ky financim, duke mbështetur me preferencë autorët e artikujve të botuar në revistat më të rëndësishme; duke patur në fokus pedagogët e rinj, por me Profesorin si qendër të vendimmarrjes. Lehtësim i procedurave të administrimit të këtyre fondeve, për t'i bërë efikase dhe të përdorshme.
- Të punohet për ngritjen e një reviste shkencore të Universitetit të Tiranës, me qëllim kthimin e saj në një mjet të rëndësishëm komunikimi shkencor dhe me faktor ndërkombëtar impakti. Të ngrihet Shtëpia Botuese e Universitetit të Tiranës.
- Të motivohet personeli akademik përmes instrumentave të vlerësimit të brendshëm të vazhdueshëm, matjes së treguesve të cilësisë në mësimdhënie dhe në kërkim.
- Të rifillojnë menjëherë studimet e nivelit doktoral, mungesa e të cilave prej shumë vitesh ka paralizuar një drejtim thelbësor të funksionimit të Universitetit.
- Që me fillimin e vitit të ri akademik të nisë procedura e krijimit/vënies në funksion të Komisioneve të Gradave Shkencore dhe unifikimi i Rregullores së funksionimit të tyre.

- Vënia në funksionim të plotë e Sistemit Elektronik të Informacionit do të lehtësojë komunikimin, dokumentacionin dhe do të krijojë një imazh profesional dhe serioz për Universitetin.
- Mësimi online të fillojë të marrë status legal në jetën akademike, sidomos në nivelin master, përmes rregullash të përcaktuara qartë.
- Në emër të autonomisë universitare në përcaktimin e kriterëve të pranimit, në mbrojtje të nivelit dhe cilësisë së programeve tona të studimit, të zhvilluara e konsoliduara gjatë shumë dekadave, të angazhohemi për rishikimin e kriterit diskriminues të notës mesatare në hyrje ndaj disa drejtimeve prioritare të diplomimit.
- Të rritet bashkëpunimi i fakulteteve të mësuesisë me sistemin e arsimit parauniversitar.

III. Universiteti për studentët

- Në programet e fushatave universitare, studentët janë konsideruar gjithmonë si një ndër forcat kryesore motivuese në realizimin e misionit tonë. Praktikisht, pak gjë është bërë në këtë drejtim. Por, lëvizjet e fundit studentore, të drejtuara kryesisht nga studentët e Universitetit të Tiranës, e shumëfishuan besimin tek roli i tyre në zhvillimin e Universitetit. Kështu, fuqia studentore mund të konsiderohet realisht aleatja më e mirë e çdo përpjekjeje për cilësi të lartë diplomimi. Kjo aleancë duhet të realizohet përmes mirëqënies së studentëve tanë, koncept që përfshin kushtet e përshtatshme të punës dhe jetesës së tyre, marrëdhëniet korrekte e bashkëpunuese me profesoratin dhe cilësinë e lartë të formimit dhe informimit.
- Të rishikohen me objektivitet tarifat e shkollimit sipas çdo programi studimi, në të tria ciklet e studimit.
- Të punohet për përmirësimin e kushteve të punës së studentëve në ambientet e fakulteteve; të zgjerohen hapësirat e bibliotekave, sallave të studimit me kushte optimale dhe lidhje internet, si dhe të zgjatet orari i tyre, aq sa të jetë i mjaftueshëm për

çdo student që frekuenton këto mjedise pune; të krijohen lehtësi për paisjen e studentëve me tekste dhe materiale mësimore.

- Të futet praktika e mbështetjes financiare të studentëve që janë pjesë e kërkimit shkencor të pedagogëve; studentët doktorantë duhet të jenë pjesë e integruar e departamenteve përkatëse; të nxiten shkëmbimet studentore në kuadrin e projekteve evropiane Erasmus.
- Fakultetet të krijojnë qendrat efikase të zhvillimit të karrierës, me kontributin e studentëve të nivelit master apo doktoratë; të krijohet baza e të dhënave mbi punësimin e studentëve të diplomuar nga Universiteti i Tiranës, e cila ndihmon për orientimin në tregun e punës; të krijohet një strukturë efikase për lidhjen me studentët pas diplomimit, si dhe mbështetjen dhe këshillimin e tyre.
- Të punohet për krijimin e lidhjeve me Shoqëritë që operojnë në fushat përkatëse të diplomimit; të institucionalizohet kryerja e praktika profesionale pranë tyre; të lidhen e konkretizohen marrëveshje me ministritë e linjave.
- Të rritet bashkëpunimi dhe mbështetja financiare nga institucioni për qeverinë studentore, në drejtim të gjallërimit të jetës së studentëve me aktivitete shkencore, kulturore e fizike.
- Të mbështeten studentët në përpjekjen e tyre për të marrë përfitime reale nga karta e studentit.
- Të vijohet puna për përmirësimin e kushteve të jetesës në konvikte; të marrë fund odisea shumëvjeçare për ngritjen e Kampusit Universitar.
- Është e domosdoshme dhe urgjente që Universiteti të nisë krijimin e kushteve të përshtatshme për studentët me aftësi të kufizuara.

IV. Universiteti i Tiranës, qendër e rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare

- Ndonëse Universiteti i Tiranës përmbledh potencialet më të mira intelektuale dhe programet më të mira të studimit, panorama që tregojnë vlerësimet e agjencive akredituese nuk është ajo që përfaqëson realisht Universitetin. Ai ndodhet i renditur në nivele shumë të ulëta në listën e Universiteteve evropiane e rajonale, i tejkualuar edhe nga disa Universitete jopublike shqiptare. Imazhi i Universitetit të Tiranës duhet ndryshuar. Duhet kthyer dinjiteti i këtij institucioni qëndror të arsimit. Efekti i tij në shoqëri duhet të barazohet me potencialet që ai mban brenda vetes.
- Të punohet me përparësi për akreditimin e programeve mësimore, i cili do të nxjerrë në pah potencialet e vërteta; të ngrihen zyrat e vlerësimit në rektorat dhe brenda fakulteteve.
- Duhet rritur pjesëmarrja e Universitetit në projektet kombëtare të zhvillimit të vendit; të forcohet bashkëpunimi me të gjithë hapësirën kombëtare të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë territorit tonë, e cila konvergjon forcat dhe rrit cilësinë.
- Duhet mbështetur pjesëmarrja efektive në programet dhe projektet evropiane; duhet nxitur organizimi i programeve të studimit në drejtime të cilat çojnë në diploma apo certifikata të përbashkëta me universitetet e rajonit, apo evropiane.
- Universiteti i Tiranës duhet të jetë më tepër i pranishëm në media dhe të përdorë të gjitha mjetet e ligjshme për marrëdhënie me publikun.

Me bindjen se realizimi i programit që do të finalizojmë bashkërisht do t'i japë NDERIN e DINJITETIN e merituar UNIVERSITETIT të TIRANËS, JU ftoj në ndryshimin e shumëpritur!